



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së njëmbëdhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 20.11.2012, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Mungoi Engin Beyoglu.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së. **Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit.**

Para se të fillonin me diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **kryesuesi** i njoftoi të pranishmit lidhur me një kërkesë të Kryetarit për subvencione dhe dy propozimvendimeve që kanë të bëjnë me bartjen e mjeteve, që këto të futen në rend dite për diskutim.

Ai njëherësh i njoftoi të pranishmit për mospjesëmarrjen e tij në dy mbledhjet e kaluara, duke i falënderuar ata për mirëkuptimin që e treguan me këtë rast, me shpresë se organet e drejtësisë do ta qesin në shesh të vërtetën.

Me plotësime, njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë;
2. Propozimvendimi për dhënien e objektit komemorativ në shfrytëzim dhe menaxhim NPL "Hortikultura" SH.A.;
3. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për rastet me përkujdesje sociale;
4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK -së;
5. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit rinor lokal - Prishtinë 2013 - 2015;
6. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pajisjeve dhe mjeteve në pronësi

Faqe 1 nga 6

- të Komunës;
7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Nëntë Jugoviq;
 8. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban", në Prishtinë;
 9. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi" në Prishtinë;
 10. Propozimvendimi për fletëtransfer të mjeteve financiare;
 11. Të ndryshme.

Pika e parë

Shefqet Sylejmani bëri vërejtje në ekstrakt, në pikën e dytë, duke thënë se duhet të jetë " ... që materiali të jetë i përmirësuar, i lexueshëm.". Te pjesa që ka të bëjë me arsimin, duhet të jetë " ... se ka edhe dobësi te arsimit.", si dhe të jetë " ... edhe struktura gjinore dhe kombëtare e nxënësve."

Vërejtje bëri edhe në pikën e katërt, ku në vend të fjalëve " ... nuk qëndrojnë", duhet të jetë " ... nuk i përmbushin", e në vend të fjalës "minimale" të jetë "optimale". Gjithashtu edhe në pikën "Të ndryshme", në fund të fjalisë duhet të shtohet " ... dhe në oborrin e saj dhe përmendet Edon Myftari, drejtor i Drejtorisë së Administratës."

Me vërejtjet e dhëna, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dhjetë.

Pika e dytë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Behxhet Musliu**, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i cili tha se ky objekt është ndërtuar në pronën komunale dhe është propozuar që ky objekt të jetë në menaxhim të NPL "Hortikultura".

Aziz Pacolli tha se ky objekt ka qenë më se i nevojshëm për qytetarët, andaj dhe e përkrahim propozimin që ky objekt t'i jepet në shfrytëzim dhe menaxhim Hortikuturës.

Shemsi Veseli tha se ndërtimi i këtij objekti është një zgjidhje e mirë për qytetarët, por do të duhej që edhe në të ardhmen të mendohet për ndërtim të një objekti të tillë edhe në ndonjë lokacion tjetër, që kryesisht të jetë i dedikuar për raste te veçanta (për kryeshëndosh). Për hir të transparencës, do të ishte mirë që kësaj t'i paraprinte një marrëveshje e veçantë.

Ai propozoi që në të ardhmen këtë çështje ta ketë parasysh ekzekutivi.

Shefqet Sylejmani e përkrahu propozimin e z. Veseli dhe vendimin që ka marrë Komuna për ndërtimin e këtij objekti.

Tefik Mehmeti tha se ky objekt ka qenë më se i domosdoshëm për një destinim të tillë. Ai propozoi që tarifat të jenë më të arsyeshme e jo fitimprurëse për kompaninë. Për ish-objektin që gjendet në fillim të varrezave, kërkoi që atij t'i jepet një destinim, të ruhet nga shkatërrimi.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e objektit komemorativ në shfrytëzim dhe menaxhim NPL "Hortikultura" SHA, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për rastet me përkujdesje sociale, Valbon Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, në pika të shkurtra i prezantoi ndryshimet dhe plotësimet që kanë rrjedhë si rezultat i analizës së punës së komisionit që ka hasur në terren.

Vërejtjet, ndryshimet dhe plotësimet janë: neni 4, pika 4.1, neni 5, pika 5.3, neni 6, pika 6.2, shkronja e, neni 7, shkronjat: a, c dhe f, neni 9, shkronjat a dhe b, neni 10, pika 10.7 dhe neni 13, pika 13.1.

Për ndryshimin dhe plotësimin e disa neneve të kësaj rregulloreje, sqarime shtesë dha **Agim Salihu.**

Shemsi Veseli e përkrahu këtë propozimvendim, me disa vërejtje dhe propozime. Propozoi që të mos bëhet laramani, kryesisht te kriteret bazë, te vjetët, pra të jetë 10 vjet, me dëshmi se ka qenë banor i komunës së Prishtinës. Vërejtje bëri në nenin 4, ku kërkoi që të bëhet harmonizimi i rregullores me ligjin. Lidhur me këtë tha se do të kërkojë nga Shoqatat e dala nga lufta, që anëtarët e saj të mos jenë anëtarë të komisionit, pasi që ata në këtë komision kanë qenë tejet subjektiv. Vërejtje bëri edhe te pikët e vlerësimit (poentimit), pasi që dallojnë nga kontributi i dhënë, dhe propozoi që të ndryshohen ose të barazohen, sepse ashtu siç janë, janë në disfavor të dëshmorëve.

Shefqet Sylejmani kërkoi që për shfrytëzuesit e banesave të jetë një zgjidhje për të gjitha kategoritë, që banesat t'iu jepen në shfrytëzim për 40 vjet. Propozoi që në kriterin e të ardhurave personale – mujore, në vend të 3 pikëve të jetë 4 pikë.

Tefik Mehmeti propozoi që te afati i kontratës për shfrytëzim të jetë 5 vjet e jo 10 vjet.

Aziz Pacolli, propozoi që nëse në afatin prej 6 muajve pronari nuk ka mundësi ta paguajë qiranë, të mos i merret banesa.

Ai kërkoi që të hiqet pagesa e qirasë për rastet sociale.

Kryesuesi tha se çështja e qirasë është kategori ligjore dhe nuk mund ta ndryshojmë.

Me vërejtjet dhe propozimet e dhëna, u konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për rastet me përkujdesje sociale, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për anëtarët e

familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK -së, Valbon Krasniqi propozoi që neni 5 të harmonizohet me nenin 7.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënien e banesave të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK -së dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e pestë

Vlora Dumoshi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i informoi të pranishmit lidhur me Propozimvendimin për miratimin e Planit të veprimit rinor lokal - Prishtinë 2013 - 2015.

Shemsi Veseli tha se është obligim ligjor që Komuna e Prishtinës ta ketë një plan veprimi për rininë, që të avancohet pozicioni i saj, andaj në të ardhmen ky plan duhet ta ketë një strategji veprimi afatshkurtër dhe afatgjatë.

Shefqet Sylejmani e përkrahu këtë vendim, duke thënë se kjo ka qenë kërkesë e kohës, andaj dhe e votojmë për miratim. Do të ishte mirë që, në kuptim të qartësisë dhe të drejtshkrimit, titulli i këtij propozimvendimi të ndryshohet. Gjithashtu edhe në aspektin gjuhësor ky dokument të korrigjohet, si dhe disa fjalë që konsideroj se janë të huaja, të shkruhen shqip.

Me vërejtjet dhe propozimet e dhëna, u konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit rinor lokal - Prishtinë 2013 - 2015 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin për dhënien në shfrytëzim të pajisjeve dhe mjeteve në pronësi të Komunës, në pika të shkurtra informoi Agim Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, i cili tha se shfrytëzimi i pasurisë së zjarrfikësve do të bartet në kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pajisjeve dhe mjeteve në pronësi të Komunës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim .

Pika e shtatë

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Nëntë Jugoviq dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tetë, e nëntë dhe e dhjetë

Faqe 4 nga 6

Lidhur me Propozimvendimin për lejimin e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban" në Prishtinë, Propozimvendimi për lejimin e mjeteve kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi" në Prishtinë dhe Propozimvendimi për fletëtransfer të mjeteve financiare, të pranishmit i informoi Xhelil Bekteshi, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

U konstatua se njëzëri u përkrahën: Propozimvendimi për lejimin e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban" në Prishtinë, Propozimvendimi për lejimin e mjeteve kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi" në Prishtinë dhe Propozimvendimi për fletëtransfer të mjeteve financiare, dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

**Pika e njëmbëdhjetë
Të ndryshme**

Shefqet Sylejmani ngiti disa shqetësime:

1. Kërkoj që gjatë hartimit të materialeve të ndryshme, të tregohet kujdes në harmonizimin e titujve, pra të jetë një model;
2. Kërkoj që të përshpejtohet puna e komisionit për verifikimin e lokaleve që janë dhënë në shfrytëzim në kompleksin banesor "Dielli", në lagjen "Kodra e Diellit";
3. Kërkoj që të shihet mundësia dhe të hulumtohet një lokacion mbrapa Bibliotekës Kombëtare, që të na mundësohet ndërtimi i një zyre për nevojat e partisë;
4. Kërkoj që premtimi i dhënë për linjën e re në trafikun urban: Kodra e Diellit – Plepa, të realizohet, me një kërkesë shtesë, që të shihet mundësia e zgjerimit të një kthese të rrugës afër shtëpisë së Veli Devës.
5. Kërkoj që të jetësohen kërkesat e bëra më herët për largimin e automjeteve dhe të punëtorëve të krahut nga hapësira para Gjykatës së Qarkut;
6. Kërkoj ndërtimin e një terreni sportiv dhe hapjen e pusit në lagjen "Kodra e Diellit".

Ai shprehu besimin se këto premtime do të realizohen.

Milazim Vitija pyeti se a ka përfunduar mirëmbajtja verore e rrugëve dhe kur do të fillojë mirëmbajtja dimërore e tyre. Njëherësh kërkoj të dijë se në këtë vit a do të ketë subvencionim për mbjelljet vjeshtore.

Shemsi Veseli kërkoj që të trajtohet edhe një herë Rregullorja për dhënien e banesave të Komunës në shfrytëzim me qira.

Mbledhja mbaroi në orën 16:45.

